

URDHËR
Nr. 1080, datë 11.12.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR AKSESIMIN NË BAZËN E TË
DHËNAVE TË SISTEMIT RUDA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 5, të nenit 16, të ligjit nr. 90, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të nenit 16, pika 2, e ligjit nr. 10296, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për aksesimin në bazën e të dhënave të sistemit RUDA”.
2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet:
 - a) Drejtoria e Politikave Veterinare;
 - b) Autoriteti përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve;
 - c) Autoriteti përgjegjës për kontrollin për ushqimin dhe ushqimin për kafshë.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

RREGULLORE
PËR AKSESIMIN NË BAZËN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT RUDA

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10464, datë 29.9.2011, neni 5, neni 129, germa “c”, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural miraton këtë Rregullore.

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin e procedurës së aksesit, detyrimet dhe kompetencat për administrimin, monitorimin, regjistrimin, përditësimin, me të dhëna blegtorale dhe veterinare për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, fermave blegtorale, lëvizjen e kafshëve në pikat kufitare, në mënyrë elektronike në sistemin RUDA, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga strukturat kompetente përkatëse apo nga çdo person tjetër kompetent, në përputhje me këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi. Kjo Rregullore përcakton:

- a) procedurat e mundësimit të aksesimit;
- b) strukturat kompetente për administrimin, monitorimin, regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave në sistemin RUDA;
- c) procedurën për regjistrimin e të dhënave.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë Rregullore termet e mëposhtëm, kanë këtë kuptim:

1. “Akses” është mundësi i aktivizimit elektronik në sistemin RUDA, sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive ose joekskluzive, për sigurimin e hedhjes së informacionit elektronik, si dhe për të ofruar dhe për të mundësuar shërbimet në zbatim të legjislacionit për shërbimin veterinar dhe legjislacionit për ushqimin. Akses, ndërmjet të tjerash, përfshin akses në elementet e rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, të cilat mund të përfshijnë lidhjen e pajisjeve në mënyrë fikse ose jofikse, në veçanti kjo përfshin akses të hapur në rrjetin lokal dhe akses në facilitetet dhe shërbimet e nevojshme; akses në sistemet e *software*-ve përkatëse, përfshirë sistemet mbështetëse operationale; aksesin në shërbimet e rrjetit të sistemit.
2. “RUDA” është sistemi i informacionit blegtoral dhe veterinar, regjistri elektronik ku hidhen dhe përpunohen të dhënat.
3. “Baza e të dhënave” është grumbullimi i organizuar i informacionit i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhet nëpërmjet sistemit kompjuterik.
4. “DVP” është Drejtoria e Politikave Veterinare në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë.
5. “Veterineri zyrtar” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit të shërbimit veterinar në Republikën e Shqipërisë.
6. “Inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë” në pikat e inspektimit kufitar (PIK) ka të njëjtin kuptim me ligjin e ushqimit.
7. “Ndërveprim” është procesi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet bazave të të dhënave.
8. “Web-services” është metoda e përdorur për implementimin e ndërveprimit të bazave të të dhënave, si dhe sinkronizimit të tyre.
9. “Ferma blegtorale” janë të gjitha vendet ose mjediset, në të cilat mbahen, rriten ose trajtohen kafshët, përgjithnjë ose përkohësisht, të cilat referuar legjislacionit veterinar duhet të regjistrohen.
10. “SEIR” është Sektori i Epidemiologjisë dhe Identifikim Regjistrimit në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë.
11. “Regjistrim” është veprimi me anë të të cilit informacioni për kafshët (si: identifikimi shëndeti i kafshëve, lëvizja, certifikimi, epidemiologjia, stabilimentet), mbledhet, shënohet dhe ruhet në mënyrë të sigurt për përdorim në përputhje me ligjin për shërbimin veterinar.
12. “Autorizim” është vendimi i SEIR-it, i cili lëshohet në përputhje me parashikimet e nenit 4 të kësaj Rregulloreje.
13. “Institucion administrues i të dhënave” është ministria përgjegjëse për bujqësinë.
14. “Institucion administrues i infrastrukturës” është AKSH-i, si institucioni kompetent i ngarkuar nga ligji për krijimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike të institucioneve shtetërore.

KREU II KËRKESA, AKSESI DHE NIVELET PËRKATËSE

Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesës

1. Kërkesa për autorizimin dhe mundësimin e aksesit në bazën e të dhënave shoqërohet me çdo të dhënë apo dokument mbështetës provues mbi të cilin arsyetohet kërkesa. Kërkesa mund të paraqitet vetëm nga strukturat e përcaktuara me këtë Rregullore apo legjislacionin në fuqi.
2. Pas shqyrtimit të kërkesës brenda afatit të arsyeshëm ajo pranohet ose refuzohet nga SEIR-i.
3. Vendimi i arsyetuar për pranimin ose refuzimin e kërkesës i vihet në dispozicion kërkuarit brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit.
4. Në rastin kur kërkesa pranohet, SEIR-i e përcjell vendimin e saj për autorizimin e aksesit, në strukturën përgjegjëse të administruesit të infrastrukturës ose operatorit ekonomik të kontraktuar për krijimin e aksesit elektronik në bazën e të dhënave.

Neni 5

Aksesi në bazën e të dhënave

1. Aksesi në bazën e të dhënave kryhet në përputhje me nenet 4, 6 dhe 7 të kësaj Rregulloreje.
2. Kur nëpunësi përgjegjës, i caktuar i strukturave kompetente, sipas parashikimeve të kësaj Rregulloreje nuk ka mundësi të kryejnë funksionin e ngarkuar, bëhet zëvendësimi i tij.
3. Aksesimi i serverit në bazën e të dhënave nga nëpunësi përgjegjës kryhet nëpërmjet kredencialeve personale, duke bërë të mundur identifikimin e tij në sistemin elektronik RUDA, sipas legjislacionit që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.
4. Të gjitha llogaritë hapen nga administratori i infrastrukturës ose operatori ekonomik i kontraktuar.
5. Veprimet e kryera në bazën e të dhënave regjistrohen dhe ruhen nga institucioni administrues i infrastrukturës, duke përdorur kodin identifikues të personit të ngarkuar që ka kryer veprimin, datën e orën e konsultimit, fjalët kyç të përdorura për kërkimin dhe të dhënat e konsultuara.
6. Administrues i infrastrukturës, në rast të konstatimit të veprimeve të parregullta nga secila palë, pezullon menjëherë aksesin e personit, i cili ka vepruar në kundërshtim me ligjin apo udhëzimet e procedurat për administrimin e bazës së të dhënave. Pezullimi dhe/apo largimi nga baza e të dhënave nuk përjashton përgjegjësinë disiplinore, civile ose penale, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 6

Niveli i aksesimit

1. Niveli i aksesimit në bazën e të dhënave është si më poshtë vijon:
 - a) veprimet në bazën e të dhënave kryhen nga strukturat kompetente, sipas përcaktimeve të nenit 7, të cilët kanë të drejta regjistrimi, përpunimi, raportimi, leximi, shkrimi dhe përditësimi për të dhënat e regjistruara në regjistër;
 - b) aksesimi sipas këtij neni është i drejtpërdrejtë i pakufizuar në leximin e të dhënave që ndodhen në bazën e të dhënave.

KREU III

STRUKTURAT KOMPETENTE

Neni 7

Strukturat kompetente për regjistrimin e të dhënave

1. Strukturat kompetente për aksesimin, regjistrimin dhe monitorimin e të dhënave në përputhje me këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi janë:

- a) DPV;
- b) veterineri zyrtar;
- c) inspektori i ushqimit dhe i ushqimit për kafshë në pikat e inspektimit kufitar (PIK)
- ç) administruesi i infrastrukturës ose operatori ekonomik i kontraktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Regjistrimi i të dhënave

1. Të dhënat e fermave blegtorale të regjistruara hidhen dhe mbahen në bazën elektronike kombëtare të të dhënave në sistemin RUDA, sipas manualit të përdorimit të aplikacionit Mobile-RUDA “Regjistri i Fermës”.

2. Veterineri zyrtar plotëson *online*¹ formularin tip të regjistrimit të fermës në bazën elektronike të të dhënave në sistemin RUDA, të cilat përditësohen në vazhdimësi. Fermeri paraqet kërkesë për regjistrim pranë zyrave rajonale të veterinarisë. Për fermat e reja afati është brenda 30 ditëve.

3. Formulari plotësohet nga mjeku veteriner zyrtar me të dhënat e mëposhtme:

- a) informacioni personal i mbajtësit, pronarit të kafshës (emër, atësi, mbiemër);
- b) të dhëna mbi vendndodhjen e fermës (qarku, rrethi, njësia administrative, fshati);
- c) gjendja e kafshëve në fermë (inventari).

4. Veterineri zyrtar, pas njoftimit përmes formularit tip A, plotëson *online* të dhënat në sistemin RUDA për sëmundjet me lajmërim të detyrueshëm, verifikon rastin, merr kampione, kontrollon situatën epizootike të sëmundjes së shfaqur në kafshë dhe përhapjen e saj në fermë/fshat/njësi administrative, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe atij publik.

4. Shërbimi rajonal veterinar merr masa veterinare, në përputhje me nenet 15, 20, 21 dhe nenin 24 të ligjit për shërbimin veterinar, ku pas përfundimit të kësaj procedure veterineri zyrtar plotëson *online* formularin tip sipas seksionit B.

5. Veterineri zyrtar ushtron kontrolle periodike në fermën/fshatin e infektuar në varësi të sëmundjes dhe rrezikshmërisë së saj, sipas vlerësimit “e lajmërueshme” ose “menjëherë e lajmërueshme”², si dhe plotëson *online*, formularin tip sipas seksioni B. Ai plotëson formularin tip derisa sëmundja të deklarohet e eliminuar.

6. Veterineri zyrtar në treg verifikon certifikatat e lëvizjes, ku ai pranon ose krijon një certifikatë të re *online*. Veterineri zyrtar duhet të plotësojë informacionin e mbetur në mënyrë që të plotësohet certifikata dhe të kryhet lëvizja e kafshëve, sipas manualit të përdorimit të aplikacionit mobile “RUDA Tregu”.

7. Veterineri zyrtar në thertore verifikon certifikatat e lëvizjes, ku ai pranon ose krijon një certifikatë të re *online*. Veterineri zyrtar duhet të plotësojë informacionin e mbetur në mënyrë që të plotësohet certifikata dhe të kryhet lëvizja e kafshëve, sipas manualit të përdorimit të aplikacionit mobile “RUDA Thertore”.

Neni 9

Monitorimi i të dhënave dhe strukturat kompetente

¹ Regjistrimi në sistemin RUDA mund të kryhet edhe kur nuk ka shërbim interneti.

² Neni 4 i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”.

1. DVP-ja monitoron në mënyrë të vazhdueshme të dhënat e regjistruara dhe në bazë të raporteve epidemiologjike të marra nga sistemi RUDA, përcakton çdo vit numrin dhe llojin e sëmundjeve infektive, që do t'u nënshtrohen masave diagnostikuese, analizave, ekzaminimeve anatomo-patologjike, vaksinimit, gjurmimit dhe çrrënjësjes së tyre për të siguruar një situatë të pastër epidemiologjike.

2. Monitorimi dhe studimi i situatës epizootike në nivel kombëtar, qarku, bashkie, komunë dhe përcaktimin e shpenzimeve financiare të nevojshme kryhet nga DPV-ja.

3. SEIR-i në ministri, pasi merr informacionin, kryen këto funksione:

- a) monitoron dhe ruan informacionin;
- b) integron të dhëna në funksion të përgatitjes së raporteve veterinarë;
- c) kryen krahasime statistikore;
- ç) analizon informacionin; si dhe
- d) jep konsulencën përkatëse pranë autoriteteve përkatëse.

Neni 10

Administrimi i bazës së të dhënave

1. Institucioni administrues bën përpunimin e të dhënave personale në bazën e të dhënave vetëm me qëllim të ofrimit të shërbimeve elektronike, në përputhje me parimet dhe përcaktimet ligjore, sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Administratori i infrastrukturës përgjigjet për krijimin, zhvillimin, sigurinë e infrastrukturës, mirëmbajtjen e sistemeve teknologjike të informacionit dhe të komunikimit, për infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën.

3. Krijimi dhe rikthimi i kopjes rezervë do të bazohet dhe kryhet në rezultatet e analizës së sigurisë, ku do të përcaktohen nivelet e kritikalitetit që paraqiten dhe ndarja në kategori, sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 1, datë 31.7.2023, "Për zbatimin e dokumentit të përditësuar të politikave të vazhdimësisë së punës dhe planit për ruajtjen e informacionit".

4. Të dhënat transferohen për arkivim në përputhje me legjislacionin për arkivat dhe dokumentin elektronik.

5. Auditimi kryhet në përputhje me përcaktimet e ligjit për bazën e të dhënave si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 11

Përputhshmëria e të dhënave

1. DPV-ja në bashkëpunim me administratorin e infrastrukturës dhe strukturat kompetente për regjistrimin e të dhënave vendos sisteme të përshtatshme dhe që sigurojnë në mënyrë automatike, periodikisht, të paktën 1 herë në muaj, përputhshmërinë e të dhënave të regjistruara në bazën e të dhënave me:

a) të dhënat e disponuara për atë fermë/fermer/kafshë/thertore/tregje/spitale veterinarë/klinika veterinarë/depo farmaceutike për medikamente veterinarë/kullotat; dhe

b) me të dhënat për subjektet që eventualisht i regjistrojnë të dhënat sipas germës "a".

2. Në rast konstatimi të gabimeve teknike apo gabime të tjera gjatë apo pas regjistrimit të dhënave, me kërkesë apo kryesisht korrigjohen nga administratori i infrastrukturës, i cili më pas raporton pranë DPV-së.

3. Krahas detyrimeve për raportimin e shkeljeve, në rast të konstatimit të mospërputhjeve midis të dhënave, administratori i infrastrukturës është i detyruar të ruajë të dhënat e këtyre mospërputhjeve dhe hapat që janë ndërmarrë nga ana e tij për t'i adresuar ato.

KREU IV NDËRHYRJET, LARGIMI DHE NDËRVEPRIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE

Neni 12 **Ndërhyrjet e paautorizuara**

1. Në rast të ndërhyrjeve të paautorizuara në bazën e të dhënave, administratori i infrastrukturës ose operatori ekonomik i kontraktuar, bën largimin e menjëhershëm të tyre dhe njofton pa vonesë me shkrim DPV-në.

2. Në rast të ndërhyrjeve të paautorizuara që bëjnë të pamundur shfrytëzimin e të dhënave dhe të bazës së të dhënave, administratori i infrastrukturës ose operatori ekonomik i kontraktuar, bën rikthimin dhe përdorimin e bazës së të dhënave në mënyrë të sigurt dhe njofton pa vonesë me shkrim DPV-në.

3. Në rast të sulmeve kibernetike, administratori i infrastrukturës së bazës së të dhënave ose operatori ekonomik i kontraktuar raportojnë rastin pranë autoriteteve përkatëse të sigurisë së të dhënave.

Neni 13 **Largimi nga funksioni i bazës së të dhënave**

1. Largimi i përkohshëm nga funksioni i bazës së të dhënave bëhet në rastet kur:

- a) bëhet avancimi i bazës së të dhënave;
- b) cenohet siguria;
- c) dëmtohet baza e të dhënave; dhe
- ç) ka probleme të tjera teknike;
- d) arsye të tjera të parashikuara nga ligji.

2. Largimi i përhershëm nga funksioni i bazës së të dhënave bëhet në rast arkivimi të bazës së të dhënave në hapësirën arkivuese, apo në raste tjera të parashikuara ligjore.

Neni 14 **Ndërveprimi**

1. Sistemi i të dhënave të regjistrit elektronik RUDA ndërvepron me sisteme ose regjistra të tjerë elektronikë të të dhënave, që administrohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural, institucionet e saj të varësisë dhe institucione të tjera, në përputhje me ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

2. Aksesimi i palëve të treta në bazën e të dhënave bëhet në përputhje me nenin 4 dhe në prezencën e administratorit të infrastrukturës së bazës së të dhënave, ose operatori ekonomik i kontraktuar.

KREU V PËRFUNDIMTARE

Neni 15
Institucionet zbatuese

1. Kjo Rregullore zbatohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Përgjegjës për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve dhe Autoriteti Përgjegjës për Ushqimin dhe Ushqimin për Kafshë.

Neni 16
Dispozita përfundimtare dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.
2. Dispozitat e akteve të tjera nënligjore për regjistrimin e të dhënave në regjistra elektronikë, të cilët janë në fuqi zbatohen për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e kësaj Rregulloreje.
3. DPV-ja, me propozimin e autoriteteve përgjegjëse, sipas nenit 15, miraton me urdhër të ministrit “Manualin e riskut mbi kontrollin e lëvizjeve të kafshëve të gjalla në pikat e inspektimit kufitar”.